

# FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

## SikaCeram® LatexGrout

### LATEKS GOME SINTETIKE PËR BOJAKËT PREJ ÇIMENTOJE

#### PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

SikaCeram® LatexGrout është emulsion ujqor rrëshirash specifike dhe aditivësh të posaçëm, për t' u përdorur në vend të ujit për përzierjen e serisë së bojakëve SikaCeram® (SikaCeram® SmallGrout, SikaCeram® LargeGrout, SikaCeram® CleanGrout), që u jep fushave të aplikimit papërshkueshmëri dhe rezistencë të lartë dhe më pak porozitet dhe absorbueshmëri.

#### PËRDORIMET

- Dysheme qeramike subjekt i qarkullimit intensiv të këmbësorëve
- Veshje qeramike të fiksuara mbi dru

- Veshje qeramike të instaluar jashtë ose në pishina
- Dysheme subjekt i pastrimit të shpeshtë dhe të plotë, si banjot
- Dushet në palestra, qendra sportive, etj.

#### KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Shton ngjitjen me pllakën
- Shton fortësinë e sipërfaqes
- Shton fleksibilitetin
- Shton rezistencën mekanike
- Redukton absorbueshmërinë

#### INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Lateks prej gome sintetike
Ambalazhi	bidon 5 kg (4.63 L)
Paraqitja / Ngjyra	Emulsion i bardhë i lëngët
Jetëgjatësia	12 muaj nga data e prodhimit
Kushtet e magazinimit	Në ambalazhin origjinal të pahapur, në kushte të thata dhe të freskëta.
Dendësia	~ 1.08 kg/L

#### INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Konsumimi	Produkti për përzierje	Sasia e SikaCeram® LatexGrout
	SikaCeram® CleanGrout:	1.4 L për qese 5 kg
	SikaCeram® SmallGrout:	1.9 L për qese 5 kg
	SikaCeram® LargeGrout:	5.5 L për qese 25 kg

## UDHËZIME APLIKIMI

### CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

- Nënshtrësata duhet të jenë trajtuar në mënyrën e duhur, të kenë strukturë të qëndrueshme, të jenë të pastra, të thata dhe pa kontaminues si pluhuri, pisllëqet, vaji, graso, kore çimentoje, efloreshencë, veshje të mëparshme ose trajtim tjetër të sipërfaqes apo pengesa si kolla e tepruar e pllakave, kryqet plastike për fugat, etj.
- Në varësi të kontaminuesve që do të pastrohen, kryeni teknika të mjaftueshme pastrimi, si pastrim me curril ose me rrymë ajri, për të hequr të gjitha gjurmët e materialeve që mund të reduktojnë ndërkapjen e produktit me nënshtrësën.
- Për aplikime në klimë / mjedise të nxehta, ose mbi nënshtrësata absorbuese, lagni paraprakisht të gjithë sipërfaqen menjëherë përpara aplikimit të produktit, por shmangni grumbullimin e ujit mbi sipërfaqe, e cila nuk duhet të jetë e lagësht në prekje dhe nuk duhet të ketë paraqitje mat të errët / të lagur p.sh. duhet të ketë tharje të mjaftueshme sipërfaqësore (saturated surface dry-SSD).

### PËRZIERJA

- SikaCeram® LatexGrout përdoret në vend të ujit për përzierjen e bojakut prej çimentoje.
- Sasia e lateksit që do të shtohet tek bojaku varet nga hollësia e pluhurit. Referohuni tek tabela e mësipërme.
- Hidhni sasinë e rekomanduar të lateksit brenda një ene të pastër dhe të përshtatshme për përzierje. Përzieni ngadalë ndërsa jeni duke shtuar ngadalë bojakun e pllakave SikaCeram® tek lateksi dhe pastaj përzieni plotësisht me mikser në shpejtësi të ulët (< 500 rpm.) derisa materiali të jetë bërë homogjen dhe të mos ketë kokrriza.
- Pas përzierjes, lëreni produktin të qëndrojë dhe të 'maturohet' për pak minuta, pastaj përzieni sërish përpara aplikimit. Miksi i përfunduar duhet të ketë konsistencë shumë kremoze, ngjyrë të njëtrajtshme dhe të përhapet dhe aplikohet me lehtësi.
- Miksi duhet të jetë kremoze dhe lehtësisht i përhapshëm me mallë gome.

### APLIKIMI

- Bojaku i pllakave SikaCeram® përzierë me lateks aplikohet me mallë duke përdorur teknikën e aplikimit kryq e tërthor, duke u kujdesur që fugat të jenë mbushur në mënyrë të njëtrajtshme në thellësinë dhe gjatësinë e tyre.
- Përdorni të njëjtën mallë në pozicion vertikal, për të larguar pjesën e tepruar nga sipërfaqja e pllakave.
- Kur materiali fillon të mpikset, mund të nisë hapi i parë i pastrimit me një sfungjer të njomë. Pjesa e mbetur e bojakut mbi sipërfaqen e pllakave duhet të pastrohet menjëherë pas pastrimit fillestar me një sfungjer të lagur kur përdorni SikaCeram® LatexGrout.
- Shmangni aplikimin në rrezatim të drejtpërdrejtë diellor dhe/ose thatësi të tepruar apo erë të fortë.
- SikaCeram® LatexGrout, përdoret në vend të ujit, nuk

e ndryshon asnjëherë ngjyrën e bojakut. Nuk rekomandohet stukimi i fugave të pllakave me SikaCeram® LatexGrout paralelisht me ato të stukuara me ujë, pasi porozitetet e ndryshme të dy bojakëve të ngurtësuar do të shfaqnin ndryshimin e miksit.

### MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit menjëherë me ujë pas përdorimit. Materiali i fortësuar mund të hiqet vetëm mekanikisht.

### KUFIZIME

- Të mos përdoret mbi materiale me sipërfaqe absorbuese si pllakat Cotto Toscano apo të ngjashme. Në këtë rast, përzieni përzierjen vetëm me ujë.
- Të mos përdoret nën ekspozimin e drejtpërdrejtë të rrezeve diellore.
- Të mos përdoret për mbushjen e fugave të zgjerimit apo hapësirave subjekti lëvizjeve të forta. Në këtë rast, përdorni serinë e produkteve Sikaflex® ose Sikasil®.

### BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

### KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

### EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

## SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porosinë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

### Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park  
Ndërtesa nr. 7, kati 4  
Tiranë - Shqipëri  
Tel.: +355 4 454 0070  
alb.sika.com  
Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit  
SikaCeram® LatexGrout  
Prill 2019, Botimi 01.01  
020404010010000008

SikaCeramLatexGrout-sq-AL-(04-2019)-1-1.pdf